



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 4943/11, Prot.

Tiranë, më 29.10.2021

Lënda: Kthim përgjigje.

ZËRI I AMERIKËS
Z. ARMAND MERO

I nderuar z. Mero!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e redaksisë suaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 43, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4943 Prot., datë 26.10.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në seancën plenare të datës 25.10.2021, vendosi pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve z. Petrit Aliaj dhe z. Nazmi Troka, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Vlorë, deri në përfundimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë.

Vendimi i sipërcituar është mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 145, në lidhje me nenin 126, të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji për Statusin), në nenin 86, shkronja “e” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ligji për Statusin ka rregulluar edhe pezullimin e procedimit disiplinor në nenin 145, dispozitë kjo që referon në nenin 126 të tij, që bën fjalë për pezullimin e hetimit disiplinor. Në shqyrtimin e këtij procedimi disiplinor, Këshilli ka marrë në konsideratë edhe faktin se z. Aliaj, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në kuadër të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, objekt i veprimtarisë së të cilit është pikërisht verifikimi i kërkesave kushtetuese për vijimin e mbajtjes prej tij të statusit të magjistratit, ndonëse shkelja e dyshuar disiplinore në rastin konkret nuk lidhet me faktet objekt i procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij. Por, pavarësisht kësaj, duhet theksuar se procesi i rivlerësimit kalimtar, si një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, e ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, nuk është një rrethanë, pjesë e rregullimeve të përhershme ligjore në Ligjin për Statusin lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, kjo në mënyrë të vetëkuptueshme për shkak të përkohshmërisë së zbatimit të tyre.

Qëllimi i nenit 126, pika 1, të Ligjit për Statusin është dhënia përparësi e proceseve të tjera ligjore ndaj magjistratit në raport me procedimin disiplinor, duke kushtëzuar këtë të fundit me përfundimet e tyre, sa kohë ato kanë lidhje dhe ndikim të drejtpërdrejtë në procesin disiplinor. Në rastin konkret, është e dukshme se mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj z. Aliaj, kushtëzon vijimin e procedimit disiplinor ndaj tij, në harmoni dhe me përcaktimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga Këshilli (neni 97, pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar), duke përligjur pezullimin e këtij procedimi disiplinor. Neni 66 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon një parakusht procedural me marrjen e një vendimi të ndërmjetëm për pezullimin e procedurës. Në referencë të këtij neni gjatë zhvillimit të një procedure administrative, mund të lindë një çështje ligjore e cila: i) duhet të zgjidhet përpara se organi publik të mund të përfundojë procedurën, dhe ii) zgjidhja realizohet nga një procedurë e veçantë administrative apo gjyqësore. Neni 66 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton detyrimin e organit për të pezulluar procedurën, për sa kohë që çështja paraprake nuk është zgjidhur.

Duke iu rikthyer çështjes konkrete, ndërsa aktualisht është vënë në diskutim ekzistenca e një shkakut kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Aliaj, në kushtet kur është "Shkarkuar nga detyra" nga organi disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit ndodhet për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit, Këshilli vlerëson se një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të Ligjit për Statusin dhe në nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Pra, jemi në kushtet e *pezullimit të procedurës*, në referencë të Nenit 66 i Kodit të Procedurave Administrative. Mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga z. Aliaj, në kuptim të Ligjit për Statusin, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj magjistratit, në kuptim të kësaj dispozite, në kushtet kur shkarkimi nga detyra e magjistratit përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor, sipas nenit 139, pika 1, shkronja "c", nenit 134, pika 1, shkronja "ç" dhe nenit 64, pika 1 shkronja "c" të Ligjit për Statusin.

Gjithashtu, Këshilli në këtë vendimmarrje ka vlerësuar se ndarja e procedimit disiplinor për dy magjistratët me objekt të njëjtë procedimi do të paragjykonte procesin për magjistratin, për të cilin gjykohet se procesi i hetimi disiplinor duhet pezulluar. Përveç kësaj, shkëlja e pretenduar për z. Troka është brenda periudhës së rivlerësimit, ku në alternativë të marrjes të një mase më të rëndë nga KPK sesa ajo e kërkuar nga ILD, do ta bënte të pavend këtë procedurë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI